VENDIM
Nr. 46/2012

PËR MOSMIRATIMIN E KËRKESËS SË NJË GRUPI DEPUTETËSH "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PËR KONTROLLIN E ZBATIMIT TË LIGJIT NË VEPRIMTARINË E MINISTRISË SË MBROJTJES DHE STRUKTURAVE NË VARËSI TË SAJ PËR PERIUDHËN JANAR 2010 – TETOR 2012"

Në mbështetje të nenit 78 pika 2 të Kushtetutës, nenit 4 pika 1 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, si dhe vendimeve nr. 18, datë 14.5.2003, nr. 26, datë 4.12.2006, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 12, datë 20.5.2008 dhe nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Mosmiratimin e kërkesës së një grupi deputetësh "Për ngritjen e komisionit hetimor për kontrollin e zbatimit të ligjit në veprimtarinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe strukturave në varësi të saj për periudhën janar 2010 – tetor 2012", për shkak se objekti i punës së këtij komisioni, i propozuar në këtë kërkesë, është në kundërshtim me nenin 77 pika 2 të Kushtetutës, si dhe vendimet nr. 18, datë 14.5.2003, nr. 26, datë 4.12.2006, nr. 20, datë 4.5.2007, nr. 12, datë 20.5.2008 dhe nr. 22, datë 5.5.2010 të Gjykatës Kushtetuese.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Miratuar në datën 8.11.2012